

BIBLIOTEKA

85H-1

B37


*andi bejtja*

ONUFRI

854-1  
337

# ANDI BEJTJA

# HON



54608

*poezi  
dhe  
tregime*

Onufri

*Redaktor: Xhevahir Spahiu*  
*Korrektor letrar: Pajtim Bejtja*  
*Faqosja: Romeo Teneqexhi*

**© Andi Bejtja**

**Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese  
ONUFRI Elbasan, shtator 1995  
Tel/Fax. + 545 2043**

## *andi bejtja*

lindur në Tiranë, në dhjetor 1969. U diplomua në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi. Diplomoi me temën "Poezia e Nazim Hikmetit". Pa mbaruar universitetin filloi karierën gazetareske, duke punuar në gazeta të ndryshme të shtypit shqiptar, ku kryesishët u mor me shkrime politike. Ka qenë zv/ kryeredaktor i gazetës "Sindikalisti", kryeredaktor i gazetës "Dita Informacion" dhe dy vjet e fundit ka mbuluar politikën pranë sektorit politik të së përditshmes "Koha Jonë". Që prej qershorit 1995 është kryeredaktor i revistës kulturore "AKS".

Botimet e para në poezi dhë prozë mbajnë emrin e gazetës "Studenti", për të botuar më pas edhe te "Zëri i Rinisë" e "Drita". Vëllimin e parë me poezi të titulluar "Fall", e publikoi në vitin 1993. Ky është libri i tij i dytë.

## *parathënie*

Tani që ju  
Nuk para lexoni poezi,  
Unë shkruaj më shumë.  
Eshtë një kokëmushkësi e kotë  
Por konkrete,  
Si kjo kometë që zhgarravit në qiell  
Eshtë një inat ujor,  
Që tokën e bën të rrafshtë  
Si në legjendat e vjetra biblike;  
Tipik për Bashkësinë tonë  
Të përbërë nga  
Fjalë, zjarr, èndrra dhe letër;  
Për racën tonë  
Të dalë jashtë mode.

Unë nuk dua të flas më  
Njerëz,  
Ne j'u kemi lënë me barrë  
Në shtrat pa shkuar ende.

## *lindje*

Ndodhesha në bark të nënës  
Duke luajtur me qiellin e barkut të saj  
Herë-herë  
Yje përkëdheljesh  
Më binin mbi kokën tullace  
Dhe në gjuhën e lëngët  
Më vdisnin dhjetëra kuaj fjalësh  
Që do të rilindin më vonë.  
Ndjeja si po më formoheshin gishtërinjtë  
Dëshira e madhe për të trokitur diku...  
Sa guxova të mendoj  
Veten e gjeta burrë  
Për pak do isha bërë plak.  
Ndodhem në bark të nënës  
Duke pritur të bëhem foshnje:

## *hon*

Ne lindëm nga një PSE  
Dhe kërkonim të bëheshim SEPSE,  
Por s'mund të ishim më tepër  
Se  
PSE + PSE  
E  
PSE + PSE  
=  
Me një grusht mjegull  
Që

## *stresnajë*

Dritaren e mbyll lehtazi, xhami përsëri thyhet  
I shkund qerpikët dhe shikoj kodra të virgjëra  
Që përpiken të kthehen me fytyrë nga dielli.  
Humbin të gjitha kohët  
Dhe e djeshmja fle në shtrat me të nesërmen  
Teksa e sotmja e djersitur  
Endërron të shkatërrojë krevatin.  
Babai niset për udhë  
E nëna shfleton albumin e fotografive  
Dy rrokje të dehura shkëputen nga trupi i fjalës  
Qëndrojnë me orë të tëra para pasqyrës  
Krihen e lyejnë buzët me të kuq  
Për t'i shpëtuar monotonisë e plakjes:  
Dielli s'ndriçon aty ku dua unë;  
E dashura ime,  
Nën barkun tënd një trëndafil i fishkur  
Por Apokalipsi kurrë nuk ndodh  
Sepse nervat tona mbajnë planetet.

## *çdo ditë...*

Çdo ditë

Pres

Të më ndodhë

Diçka e re

Diçka e pabesueshme

Diçka e jashtëzakonshme

Fundja fundit

Të jem

Një majmun i gjëzuar

Majë një pemë

Që botën e kundron me një

Buzëqeshje hyjnore, fillestare

O Zot,

Majmun u bëra,

Por këtu

Nuk ka asnjë pemë!

## *shtëpia jonë*

Hija e njerkut përkund vetveten  
Babai nuk dimë se ku ka shkuar

Në shtratin tim fle një mace e egër  
Në pyll baret lakuriq e dashura ime  
ideale

Në guzhinë një statujë më ngroh gjellën  
Nëna qëndron gjithmonë prapa perdes

Me një kryq druri në dorë  
Krishti troket në portën tonë  
Duke na u përgjëruar më kot  
Që ta kryqëzojmë...

## ***kërmill***

M'u desh kohë ta kuptoj  
Se jam një kërmill  
Që iu ngjita një mali  
Të cilin e krijova vetë

Kjo është humbja ime  
Fitorja ime gjithashtu

## ***shfletim***

Duke kerkuar thelbin e jetës  
Pa dashje  
Mbeta si zog i plagosur  
Nëpër degët e Biblës  
Pastaj lexova Kuranin  
Pastaj të shfletova ty  
Grua  
Vazhdimisht  
Vazhdimisht  
Deri  
Në  
Zbrazëti

limonat 

Plotësish limonatë,  
Madje dhe detin do ta kthej në  
Limonatë  
Për të kapur  
Thelbin e jetës

## *dashuria është orë...*

Dashuria është orë  
Pa akrepa  
Ishull pa det  
Kohë pa kohë  
Kapele pa kokë  
Kokë pa kapele  
Dashuria është orë  
Pa akrepa

Akrepa janë këmbët e tua  
Kur ti bëhesh e mërzitshme

*54608*



***me kokën  
në gjunjët e tu***

Me kokën në gjunjët e tu  
Bota është ndryshe

Vdekja s'është në mes  
Eshtë anash

Madje  
Dhe ti vetë  
Për dreq  
Je ndryshe;

Nuk je më një femër  
Që në gjunj  
Mban kokën time

## *shtrati yt*

Tashmë ajo urë dashurie  
Eshtë shkatërruar  
Po përderisa dhimbja jote  
Ende ka dy brigje  
Unë do të vazhdoj të rrjedh  
Si ujë  
Nëpër shtratin tënd  
Të mbushur me imazhe meshkujsh

## ***femër dhe disko***

Kjo muzikë  
Na bën koketa

Herë shtyhem i me bërryla  
Herë bërrylat i përdorim  
Si rrema  
Për të shkuar diku  
Për të kërkuar dikë

Po vallë, kë kërkojmë?

Burri është pas malit  
I dashuri është pas kodrës  
Zoti është pas zemrës  
Djalli është pas brekëve

Kjo muzikë  
Po na bën  
Shumë shpejt  
Koketa

Herë shtyhem me bërryla  
Herë bërrylat i përdorim  
Si rrema  
Ne kërkojmë mashkullin-  
As burrin  
As të dashurin-  
Një mashkull  
Pa formë  
Pa emër  
Një mashkull  
Që na kthen ngadalë  
Jo kaq shpejt  
Në koketa

## *dashuri mbi dashuri*

Çdo dashuri e re  
Më zë mbi një dashuri të vjetër  
Dhe s'është dashuri  
Përështë dhe dashuri

Niset përmal  
E mbetet kodër  
Sapo bëhet lumë në vjeshtë  
Kthehet përrua në shi

Dhe unë bie të flë  
Me një fytyrë majtas, një djathtas

Pa dashuri

Me dy dashuri

Në gjunj mbaj kokën tënde

Në duar flokët e një tjetër femre

E zemra si jastëk përthyhet

Por shpejt formësohet sërish

E dashura e vjetër gjithmonë thotë

“Ti je një mi”

Por unë jam një mace

Që kacavirrem pas shpirtit tim

## ***orë stilistike***

Të dashur nxënës,  
Kemi një dashuri normale  
Të cilën duhet ta paraqesim  
Sikur është një dashuri e zjarrtë, e çmendur.  
Burrit s'kemi ç'ti bëjmë  
S'ia ndryshojmë dot hundën  
As gjarprin tekaxhi mes këmbëve  
As zakonin e të ardhurit pas mesnate  
në shtëpi.

Dhe gruas nuk ia ndryshojmë dot flokët  
As njërën bebe të syrit  
Ku i është ngjitur një burrë tjetër  
Që pi vazhdimisht cigare  
Dhe ia shkund hirin mes shalëve.  
Shkurt, do të na duhet  
Të marrim një ndajfolje koketë  
Një mbiemër miklues  
Dhe një folje sensuale;  
I përzgjedhë të gjitha bashkë  
Në shtratin martesor  
Aty ku boshti i stilistikës  
Pritet me boshtin e ndjenjave  
Dhe krijojmë një koktej marramendës fjalësh;

**Por burri dhe gruaja**  
Duhet të flasin papushim  
Duke krijuar një ujëvarë stilistike  
shumëngjyrëshe, të padepërtueshme  
Po e theksoj  
Duhet të flasin papushim  
Me njëri-tjetrin  
Por sidomos me të tjerët  
Duke u thënë se sa shumë e duan njëri-  
tjetrin  
Se sa të lumtur janë me njëri-tjetrin,  
Siç bëjnë shumica e bashkëshortëve të  
pakënaqur  
Apo poetët e dështuar të kësaj bote  
Duke na sjellë gjithmonë ndërmend  
Se sa e ngjashme është hipokrizia  
Me parimet e ngurta të stilistikës.

## ***lirikë moderne***

I gëzohen projektimit të hënës  
Dëshirat  
Me avull shprese  
Shkruar  
Në mur pamundësie  
Ku tullat janë ngjitur  
Me lëndë jashtë çdo logjike.  
Shiu pret projektimin e hënës  
Breshëri pret projektimin e hënës  
Me gisht drejtuar nga dielli  
Vdiq njeriu  
Që vuante nga pagjumësia.

## ***ndërrim stinësh***

Syrin e qelqtë të vjeshtës  
Shpoi një poet  
Ndjenjat  
U mbuluan nga dëbora

## *natë vere*

Kaq kohë hëna pret  
Pret hëna  
Të kalojë ndonjë re  
Për të fshirë lotët e saj  
Të arta

## *nata gjithmonë është larg*

Nata gjithmonë është larg  
Do kohë që bari të kërruset  
Nga hapat e padukshëm të yjeve.  
Madje, asnjëherë nuk rrëzohet gjethi  
I mbrëmjes së kaluar  
Dhe ne kurrë s'i shikojmë  
Ngjyrat e verteta të ditës.  
Ndaj, lëre ëndrrën të dremisë ca  
Lëri flokët e lagur  
Të harrohen në puhizën e detit  
Ke kohë të krihesh më vonë  
Për t'u parë  
Në vitrinat e mjegullta  
Të vdekjes

## *fjalët*

Kur unë fle, flenë dhe fjalët  
Flenë në kokën time  
Ku gjenden peisazhe që nuk ekzistojnë  
Flenë të kapura për dore  
Pa e cënuar kuptimin e fjalisë.

Unë këpus një degëz të dridhshme mendimi,  
Dhe i kullos fjalët e përgjumura  
Duke marrë ngadalë rrugën për në zemër  
Rrethuar me një paqartësi diskrete...

## ***kronikë poetike***

Sot

U diskutua në parlament

Ligji "Për kthimin

dhe kompensimin e metaforave"

Paraqitur

Nga një grup poetësh

Që s'kanë filluar

Të shkruajnë ende.

Unë natyrisht

Votova kundër

Por kundër votuan  
Dhe Eskili  
Dhe Homeri  
Ish feudalë të mëdhenj  
Që zotërojnë  
Me mijëra hektarë togëfjalësha.  
Pas dështimit  
Të këtij projektligji  
Borhesi  
Kryetar i Parlamentit  
U tha reporterëve  
“Se sot krijuam  
Hapësirën e nevojshme legislative  
Për të vjedhur  
Nga pak  
Njëri-tjetrin”

## *Pause Café*

*Në fillim, ideja për të përzier në një libër poezi dhe tregime, nuk m'u duk aspak e mirë, madje mund të them neveritëse. Por pasi u mendova pak më shumë, kjo ide m'u duk joshëse dhe plotësisht e drejtë, për arësyet e mëposhtme.*

*Së pari, disa nga tregimthet lirike të këtij vëllimi e ndjejnë veten më mirë në një libër me poezi, se sa në një libër me tregime. Ato kanë ritmin e një poezie dhe ato që mund të quhen "vatra të frysmezimit" kanë të njëjtën përbërje, ngjyrë dhe temperaturë, si gjatë momenteve kur shkruaj poezi, ashtu dhe kur kam shkruajtur këto tregimthe.*

*Por edhe tregimet e tjera më të gjata të këtij libri, pavarësisht nga gjatësia e tyre, pavarësisht se nga një lexim i parë, mund të duket sikur stonojnë me poezinë dhe minitregimet, pavarësisht se mund të kenë një intensitet tjetër, kanë atë çka më lejon mua t'i përmbledh në këtë vëllim: temperaturë të njëjtë të "vatrave". Gjatë punës për këtë libër, e kam ndjerë më shumë se currë atë që kritikët bashkëkohorë e thonë shpesh: poezia moderne është prozë dhe anasjelltas.*

## **grafi**

Eshtë një çast, një çast tejet fluror, kur fillimi  
është fund dhe fundi fillim; çasti midis ëndrrës  
dhe zgjendrës. Atë çast kisha përshtypjen se  
gjithçka po ndodhte brenda kapakëve të syve  
të mij. Përftoja njëkohësisht peisazhe, zhurmë  
dhe aromë. Një majë gjilpëre gërvishte në  
brendësi të kapakëve të syve, duke u munduar  
të krijonte ca trajta të pakuptueshme, për të  
cilit maja e asaj gjilpëre nuk ishte aspak e  
denjë. Kërcitje takash. Më parakalonin me  
shpejtësi marramendëse dhjetëra këmbë grash  
dhe këpucë burrash. Nuk e kuptoj se si në  
gjysmëndërr njeriu mund të ndjejë erën e një  
parfumi. Ishte një erë parfumi që tmerrësisht  
shpejt u përzie me një erë trupi. Në fytyrë m'u  
lëshua një tufë flokësh që përpak desh krijoj

tërmët në retinën e syrit. Më e çuditshmja ishte se unë isha plotësisht i vetëdijshëm për çka po ndodhë dhe e kisha vetë në dorë t'i hapja sytë e gjithçka të merrete fund. Era e parfumit u nda aq qartë nga era e trupit dhe u tret sakaq, sa nuk ishte vështirë të kuptohej, se ajo erë trupi ishte era e trupit tim të djersitur nga ankthi. Grafia e këtij çasti pothuaj ishte kryer dhe unë tashmë isha pothuajse i lumtur e i çliruar. Mbetej vetëm t'i hapja sytë, t'i shkulja kapakët e syve, t'i tendosja në tavolinën e vogël prej xhami në qoshe të dhomës sime dhe, në pjesën e tyre të brendshme, të mëtoja fosilët e pangjyrtë të ëndrrës.

## ***shilarësi***

Një shilarës i varur te mani në oborrin e gjyshes.  
Një djalë i vogël dhe një vajzë e vogël me një  
gërshet të vogël, shilaren në shilarësin e vogël.  
I kanë hedhur dorën në qafë njëri-tjetrit.  
Shilaren dhe këndojnë të gëzuar. Një erë e lehtë  
fillon të fryjë, ose nuk fryn fare, ose fryn fare  
pak. Ata e ndërpresin këngën dhe najviteti  
fëmijëror shpërthen.

- Se ç'ndjej diçka mes këmbëve-thotë djali.
- Edhe unë ia kthen vajza.
- Ç'të jetë vallë?
- E ka fajin era!
- Era!
- Si era!?
- Po pse era?
- Hë pra, pse era!?

Vajza ikën me vrap dhe djali e ndjek si i përgjumur. Hynë në shtëpi. Hipin në divane dhe fillojnë një betejë me jastëkë. Kapanëmbëlsisht, rrotullohen derisa bien në dysheme. Fustani rozë i saj ngrihet dhe djalthi verbërisht ia ul paksa të mbathurat për të parë se çka aty brenda. Një hop vajza e vogël stepet, më pas e shtyn dhe i lutet që të shohë dhe ajo tek ai. Shikon dhe naiviteti fëmijor merr fund. Tani ata janë shokë dhe armiq të pashmangshëm. Një erë e lehtë lëkund shilarësin e vogël. Ata nuk guxojnë të hipin së bashku. Madje, as veç e veç, sidomos kur fryn erë. Shilarësi lëkundet, lëkundet bosh. Lëkundet një shilarës i bardhë. Një shilarës i bardhë lëkundet në kthinat e kujtesës, ku dremisin kujtimet e fëmijërisë.

## *vogëlushja*

Të gjitha të ulura perdet e dritareve të autobuzit, me përjashtim të njërës, ku një vajzë e vogël shikon aq papërqendrueshëm përjashta, sa të lë përshtypjen se më tepër dëgjon se sa shikon. Dhe, po të vëresh me kujdes pozicionin e saj të tendosur, të ngrirë, ankthtregues dhe sytë, majën e njërës këmbë që prek sì me frikë dyshemenë e autobuzit dhe buzët e holla, dhe buzët e holla, në syprinën e të cilave duket sikur lëvrijnë të gjitha variantet e ngjyrës së kuqe do të thuash se ajo përgjon dëshirueshëm; a thua se gjendet prapa derës së dhomës së gjumit, në çastin kur prindërit po flasin fjalë të mira për të.

Muzgu vjen beftë, si gjithmonë në dimër, sa që asaj i bëhet sikur ky mantel i errët, akoma

ruajtës i pigmentit të bardhë të ditës, ka rënë jo nga qielli, por nga pjesa e sipërme e autobusit dhe ka rrethuar vetëm këtë autobus, enkas për të, që ajo të mund të shohë nëpërmjet xhamit, atë djalin me kitarë, të ulur në ndenjësen e fundit. Por akoma nuk duket mirë. Shoferi ndez dritat e mugëta të autobusit. Muzgu, drita e dobët e llambushkave dhe tingujt e një këngë sikur e ringjallin edhe njëherë atë afrimitet që krijohet natyrshëm gjatë udhëtimeve të gjata. Dremitësit fillojnë të çmpihen. Hamësit u zgjasin të tjerëve ushqimet. Dhe vogëlushja e ka ndërruar pozicionin e saj. Tashmë autobusi ngjan si një skenë teatri e rregulluar pa shije. "Fiona, hajde pak këtu" - e thërrasin vogëlushen vajzat studente. Ajo shkon gjithë naze, me një buzëqeshje praruese, me sy disi të perënduar, duke u fryrë lezeçëm ballukeve. Ulet te prehëri i njërsës prej vajzave. I puth të gjitha me radhë. Hesht një hop, fjalët e këngës përfshijnë dëgjuar. Një përrallë fillon të tregojë. Pa e filluar mirë akoma, e kuption që s'do të ketë sukses. Për pak kohë ikën, se gjoja e kërkon babai. Sërisht vjen. Imiton djalin që i bie kitarës. Fiton të qeshurat e studenteve. Vetëm ata që këndojnë s'ë kanë mendjen tek ajo. Një dëshirë e madhe e pushton, e miklon të tërën, që të tërheqë dhe vëmendjen e atyre që këndojnë, e sidomos të atij djalit brun që i bie kitarës e kur këndon në qafë i duken dy damarë, si dy përenj.

që në pjesën e sipërme të qafës bashkohen. Bën çmos. Afrohet. U buzëqesh atyre. I prek paksa me dorë...por asgjë, përveç disa buzëqeshjeve dhe shikimeve të papërfunduara, të amështa. Kthehet te dritarja. Rrëshqet vështrimin mbi xham. Por ajo dritare nuk mund të shërbiejë si pasqyrë, pasi xhami i saj është mjافت i pistë. Tenton ta fshijë. Shpejt kupton që pisllëku është nga jashtë. Tenton ta hapë. S'mundet, veçse një fije. Fshihet pas ndenjësen. Shoqëron me sy gllënëkën e një pijë me ngjyrë, që ai djali me kitarë kthen nga një shishe pa etiketë. Vë re bjonden përbri tij, që ai e shikon ca si tepër dhe në mënyrë të çuditshme. Një letër i kërkon babait dhe stilolapsin. Një kokë rrumbullake vizaton. Kërkon lapsat me ngjyra në çantën e saj të vogël. Bën disa flokë të verdhë (më tepër janë zhgarra) mbi kokën e rrumbullakët. Dy sy ngjyrë kafe vizaton. I ndërrohet mendja. Bën dy vrima. Qesh me vizatimin. Me ironi. Dëshiron t'ua tregojë vajzave, t'u thotë se sa shumë ngjan vizatimi i saj me atë bjonden. E gris. Herë e pezmatuar, herë e lumtur. Dritaren kërkon të hapë, për të fshirë xhamin dhe për të hedhur copërat e letarve. Copërat e letrave i hedh nga hapësira e vogël që ka mundur të krijojë. Xhamin s'e fshin dot. Shikon më inat të kotë babain. Ngrihet. Vjen përqark sipas ritmit të këngës. Përcart bërtet, në mënyrë që

t'u prishë këngën atyre... dhe atij dhe asaj... Lodhet. Shkon te vajzat. Fshin djersën që më tepër ka përshtypjen se i ka dalë për shkak të një ankthi të brendshëm, të pakuptueshëm. Këtë herë, e dorëzuar, shikon nga ata, si me dhimbje. As dëgjon fare këngën. Në vesh i bëhet se ka një kile pambuk. Gati sa nuk e zë gjumi. Zëri i një vajze e zgjon:

"Fiona, o Fiona, kush të pëlqen më shumë nga këta çunat?" Çfarë the? - përgjigjet Fiona, gjoja sikur nuk e dëgjoi pyetjen. "Si thua t'i, kush është më i mirë nga këta çunat" - pyet edhe njëherë këmbëngulëse vajza. Ehë, mërmërit indiferente Fiona, e painteresuar në dukje. T'i studiojmë njëherë - shton. Shikon gjoja kujdeshëm, tejet bukur, ngultas, duke e zgjatur shikimin në kohë të njëjtë te çdo djalë, duke u munduar të mos shfaqë pavetëdi shëm instinktet e fshehura të femrës. Ai atje-tregon me gishtin e vogël të bërë me bojë. E pse të pëlqen?-pyesin dy vajza të tjera me një gojë. Sepse - bën sikur mendohet ajo, duke dashur tëshmangë ndrojtjen- ka kitarë, këndon bukur, ka dhe sy... dhe bluzë të bukur-shton shpejt dhe ikën. Ndërsa me zërin e brendshëm radhitjen e bën ndryshe: ka flokë të bukur, sy të bukur dhe kitarë të bukur, por kjo e fundit ngaqë dora e tij ngjan hijshëm mbi të. Bluza... bluzën as që e kishte parë fare. "Ajo atje është më e shëmtura - thotë për bjonden, në intimitet,

me zë të ulët, duke lënë pezull një heshtje dhe habi, që asaj i duket se ka dalë nga sytë dhe buzët e vajzave dhe ka mbetur aty në ajër lëmsh.

Studentët vazhdojnë të këndojnë dhe të pinë. Ajo si e çmendur fillon të bërtasë me një zë çjerrës, duke u afruar për nga ata dhe duke i rënë barkut me pëllëmbëza. Bërtet, duke lëvizur kokën lart, duke u hedhur e përdredhur si të donte të shembte autobusin. Ndërkokë... "pusho grerëz"- dëgjohet zëri i fortë i djalit me kitarë. Ajo stepet. Trembet. Frikësohet. Duart i dridhen në barkun e vogël dhe sytë i mbeten për aq kohë besnikë dyshemesë së autobusit, sa ajo tulat ftyrën pas xhamit të dritäres, duke mos i lënë lotët të rrëshqasin më poshtë se mjekërsa e rrumbullakosur nga inati. Askush s'e ka vënë re. Asnjë udhëtar. As vajzat. As babai që vazhdon të bisedojë me shoferin. As llambushkat e autobusit. As ai... Fshin lotët me fundin e trikos. Fundin ngjyrë krem e rregullon që mos t'i duken kupëzat e vrara të gjunjëve. Fillon të zhgaravisë me stilolaps sipas ritmit të avashtë të këngës, parakrahët, ftyrën, pulpëzat... Edhe njëherë e kthen ftyrën nga ai, i nxjerr gjuhën, por asnjë s'e ka mendjen. Eshtë gati të qajë sérish, po e mban veten. E lodhur ndjehet dhe e fyer. E pushtuar nga ai njëkohësisht. Fyerjet dhe fjalët e mira i

pushtojnë njësoj fëmijët. "Fiona, hajde pak këtu"-e thërret babai. "S'dua"- përgjigjet gjithë inat ajo. "Hajde këtu të them". Ajo më në fund shkon, disi e lëshuar në ecje. "Ç'je bërë kështu mistrece"- e godet me pëllëmbë babai. Ajo qan, qan shumë, duke e kthyer fytyrën nga ai djali brun dhe i egër, si për t'i kërkuar ndihmë. Babai e fshin me shami dhe ajo kthehet te ndenjësja e saj. Shikon udhëtarët që kanë kthyer vështrimet e tyre nga studentët dhe për herë të parë përpinqet të kuqtojë tekstin e këngës: dritaren t'i s'e hape, se nuk të la mamaja. Edhe njëherë atë bjonden vështron dhe shkëmbimin e çuditshëm të vështrimit të asaj me të atij. I bëhet sikur këtë vështrim shkëmbimesh e ka hasur diku, në film apo në rrugë. Teksa përpinqet të hapë dritaren e autobusit, i çahet dora përgjatë gishtërinjve dhe dy pika gjaku i bien mbi fundin ngjyrë krem. Dritaren s'mundi ta hapte dot. Nxjerr shaminë dhe mbështjell pjesshëm dorën. Shikon përjashta. Errësirë. Siluetat e pemëve lëvizin si të ankthuara. I mjegullohet shikimi. Siluetat e pemëve nga shpejtësia e autobusit bëhen një sfond gri i shformuar. Ajo vë duart te hekuri përgjatë dritares dhe dremit. Harresa e shpejtë fëminore pothuajse ia largon atë figurë, ata sy, ato flokë...Ndërkohë ajo vazhdon të udhëtojë në një varkë bashkë me Elmën, Elertin dhe Violën. Lundron në një varkë me velë pak a shumë të

bardhë , si ngjyra e fundit të saj, ku kuqojnë dy pika gjaku. Kështu i bëhet në gjysmëndërr. Autobusi ka ndaluar, por ajo s’ë kupton. I duket se po sheh në ëndërr dhe një të kuq buzësh dhe autobusin që herë-herë shndërrohet në varkë. Befas, zgjohet me mendimin se buzët i ka të lyera me buzëkuqin e mamit.

## ***gjakësim femëror***

Sonja dhe Eni u takuan të shtunën në darkë në diskos dhe të djelën vendosën të jetonin së bashku. Nuk e njihnin dhe nuk e kishin parë njëra tjetrën më parë, ndaj të dyja u habitën disi nga kjo miqësi e shpejtë dhe e vrullshme, e ngjashme me atë miqësi që ndodh vetëm me dy adoleshente të virgjëra. Ishin të dyja te të 30-tat, beqare dhe jetonin vetëm. Ndoshta vëtmia ishte arsyaja kryesore që i shtyu të merrnin këtë vendim të shpejtë, por më e besueshme duket se është ajo çka Eni kishte shkruar një javë më vonë në ditarin e saj: "Të dyja ishim të delizionuara nga meshkujt". Në të vërtetë, nuk mund të quhen femra të bukura, por kishin një feminitet të veçantë që

nuk mund t'i linte meshkujt fare indiferentë. Pak javë më vonë, kur do t'i tregonin njëra tjetrës historitë e dashurisë, do të zbulonin se kishin një jetë pak a shumë të njëjtë. "Të gjitha historitë e dashurisë janë njësoj" - kishte thënë Eni. "Meshkujt një turi kanë".

Të nesërmen e asaj dite që ishin takuar në diskò, dy orë pasi kishin marrë atë vendim të shpejtë, Eni gjeti një çift grek që kërkonte shtëpi me qira dhe të hënën në mëngjes ajo nënshkroi nj kontratë 6 mujore, duke e lënë shtëpinë bashkë me plaçkat dhe sendet personale. Mbasdite ajo, me dy valixhe në dyar trokiti në derën e shtëpisë së Sonjës, e cila e priti me një shprehje të çuditshme në fytyrë, sikur donte t'i thoshte: kush je ti moj vajzë që do të jetosh me mua?

Por akulli u thye shpejt. Sonja i tregoi të gjitha vrimat e shtëpisë, duke filluar që nga enët e deri te dysheqet dhe jorganet në depo. Pasi kishin pirë kafenë e parë në atë shtëpi filluan të bisedonin për problemet financiare. Sonja punonte laborante në një institut në periferi të qytetit dhe paguhej shumë më pak se Eni, e cila punonte në një agjensi turistike me emër. Miqësia e nisur u çua më tej kur Eni tha se "paratë e shtëpisë që kam lënë me qira janë dhe të tuat". Filloi një jetë e qetë femërore, me shëtitje, duke lexuar përditë horoskopin, duke biseduar për fustanet, meshkujt, martesën dhe

periodat. Shtëpia e gjitha kundërmonte dy lloje parfumesh, era e të cilave vinte e ndarë nga dy dhomat, për t'u bashkuar në korridore, për t'u shkrirë në guzhinë, aty ku bëheshin thashethemet e mbrëmjes.

Që nga fillimi i Janarit, kur kishin filluar të jetonin së bashku, e deri në mes të marsit, asnjë mashkull nuk kishte shkelur në shtëpinë e tyre, përveç një komshiu që erdhi për të rregulluar siguresën e djegur të dritave. Në mes të marsit Sonja erdhi në shtëpi bashkë me një mik të ri, të cilin Eni nuk e pëlqeu si pamje. Ishte një arkitekt, rrëth të 35-ave, i gjatë, me disa muskuj të fuqishëm në qafë. Enit nuk i pëlqenin meshkujt e fuqishëm, me muskuj. Ajo dëshiron te ata meshkuj elegantë, të brishtë dhe mundësisht të verdhë në fytyrë. Mondi, miku i ri i Sonjës, nuk kishte asnjë fije intelektualizmi në atë fytyrë të kuqe, ndoshta nga rakia e tepërt.

Miku i ri filloi t'i viziton rregullisht deri sa një ditë ai filloi të flinte në krevatin e Sonjës. Mikeshat tani nuk shpenzonin shumë kohë me njëra tjetrën dhe Eni u detyrua t'i shikonte vetëm filmat e mbrëmjes teksa Sonja lëshonte klithma kënaqësie në shtrat. Pas pak kohësh Enit filloi t'i hynte në zemër arkitekti fytyrëkuq. Madje një ditë ajo i tha Sonjës se ishte me fat. Duke pirë kafe një mbasdite në kuzhinë, Sonja hapi një bisedë të rëndomtë, karakteristike për

të gjitha femrat e botës:

-Eni, kanë kaluar dy javë dhe nuk po më vinë periodat. Kam frikë se kam mbetur me barrë. Dhe tani nuk i kam punët mirë me Mondin.

Eni u habit se si një gëzim i brendshëm, i beftë, ia pushtoi trupin kur, dëgjoi fjalinë e fundit.

-Mos u mërzit - i tha. Gjëra që ndodhin. Do të vinë...

-Jo, jo... Unë tërë jetën i kam pasur shumë të rregullta, kam shumë frikë...

Tri ditë pas kësaj bisede, Sonjës i erdhën periodat dhe po atë ditë i erdhën dhe Enit, veçse me pesë orë vonesë. Atë ditë e festuan dhe pinë si të marra, duke mos e marrë në konsideratë faktin që, ndërsa muaj më parë i kishin periodat rrëth 20 ditë larg njëra tjetrës, tani u kishin ardhur në të njëjtën ditë.

Sonja i rregulloi sërisht punët me Mondin e ndërkohë Eni nuk po e kuptonte se si arkitekti, dikur antipatik, po i hynte gjithmonë e më shumë në zemër. Muajin tjetër periodat u erdhën sërisht në të njëjtën ditë, vetëm me dy orë diferencë. Të dy mikeshat u çuditën paksa, por nuk e vranë shumë mendjen, deri kur pas dy muajsh, në qershor, kur Eni e përsëriti kontratën me çiftin grek, periodat u erdhën vetëm me gjysmë ore diferencë. Sonja u mundua ta paraqesë si rastësi, ndërsa Eni u shqetësua seriozisht dhe vendosi të bisedonte me një mjeke, shoqe të saj në maternitet.

Mjekja i tha Enit se ky fenomen nuk ishte i panjohur dhe ishte i shpjegueshëm në mjekësi, por ajo nuk dinte ta shpjegonte në detaje. Kishte të bënte me hormonet femërore, apo me diç tjetër. Por tashmë Eni nuk ishte e shqetësuar vetëm për këtë problem. Ajo kishte frikë nga disa mendime satanike që i kishin ardhur në kokë në lidhje me të dashurin e Sonjës. Një muaj më vonë, kur Sonja nuk ndodhej në shtëpi, Eni, duke pirë e biseduar me Mondin, përpak sa nuk i ishte dhënë arkitektit, i cili ishte plotësisht i gatshëm. Atë natë, kur Mondi u largua rrëth orës 12 të natës, të dy mikeshave u erdhën periodat vetëm me 5 minuta diferencë. Këtë herë u trembën vërtet dhe për një arsyё të pashpjegueshme e panë njëra tjetrën si armike.

-Kjo është e çuditshme - kishte thënë Sonja duke dalë nga banjoja.

-Po, kjo është shumë e çuditshme - i ishte përgjigjur Eni.

Në shtator periodat u erdhën me tri minuta diferencë. Në tetor pothuajse në të njëjtën minutë. Fundi i nëntorit i gjeti të dyja me orë në dorë, duke matur sekondat. Periodat u erdhën në të njëjtën minutë. Të dyja u përlotën instinktivisht dhe më pas u përqafuan pa asnje arsyё të kuptueshme.

Disa ditë më vonë Sonja u nda nga Mondi dhe të dy mikeshat folën me aq nostalqji për këtë

mashkull, sa për një moment Sonja dyshoi se nuk kishte qenë ajo e dashura e Mondit, por Eni.

-Pse nuk gjen dhe ti një mashkull - i tha Sonja. Eni kurrë nuk i kishte lënë shteg mikeshës së saj të kuptonte ndjesitë që i kishin lindur për Mondin. Ajo, gjithashtu, kurrë nuk ia kishte shprehur dyshimin se fakti që periodat po u vinin në të njëjtën ditë e minutë, ndoshta po i bënte të kishin të njëjtat ndjenja për çdo objekt mashkullor. Apo mos vallë ishte kjo thjesht një rastësi, apo një xhelazi femërore që e shtyn femrën të afrohet me mashkullin e tjetrës? Eni, gjithashtu, nuk i kishte folur mikeshës së saj dhe për të dashurin e saj të ri, me të cilin ishte njojur tremuaj më parë. Kjo frikë kishte mbjellë shumë fiksime në mendjen e Enit. Para se të flinte ajo sigurohej mirë nëse e kishte mbyllur derën e dhomës, për të mos lejuar ato hormone, apo ç'dreqin ishin të vinin nga trupi i Sonjës te trupi i saj dhe anasjelltas. Kishte përshtypjen se kjo lëvizje e çuditshme grimcash të paidentikuara ndodhte natën. Nuk e mbante mend se ku e kishte lexuar (apo ndoshta e kishte krijuar vetë) se periodat kishin një lidhje me hënën. Por nuk kishte Perëndi që të ndalonte atë komunikim femëror. Grimcat e padukshme dilnin nga trupi i njëra tjetrës, çanin muret e dhomave, batanijet, çarçafët, lëkurat, për t'u vendosur në fund të trupave, diku aty

poshtë barkut, për t'u ngjitur më pas në zemrat  
dhe mendjet e tyre.

Periodat u erdhën në të njëjtën sekondë dhe  
në tre muajt e ardhshëm.

Eni ishte e shqetësuar dhe një ndjenjë e  
çuditshme e frenonte që t'ia prezantonte  
Sonjës mikun e saj. Ajo e ftoi atë në shtëpi  
vetëm kur Sonja i tha se atë natë do të flinte  
te prindërit e saj në fshat.

I dashuri i Enit, Arjani, kur shkeli për herë të  
parë në shtëpinë e dy mikeshave u ankua dhe  
u habit se si ajo nuk e kishte ftuar më parë.  
Çifti kishte tre muaj që bënte dashuri nëpër  
lulishte dhe shtëpitë e të tjerëve.

Pasi hëngrën një darkë të thjeshtë, pica të blera  
gati dhe pinë dy shishe verë, shkuan të etur  
në shtrat. Ai filloi ta zhvishte, duke u munduar  
t'i puthte çdo pjesë të trupit, derisa të dy  
humbën në ekstazë. Ajo ndjente erën e trupit  
të tij dhe një nrohtësi që i vinte nga pjesa e  
poshtme. Më pas e zuri gjumi. Më vonë nëpër  
gjumë ajo ndjeu dhe një erë tjetër trupi dhe  
kur arriti të numërojë vetëm me hundë, ajo  
klithi: "O zot, po ne jemi tre". Kur hapi sytë,  
arriti të dallojë konturet e fytyrës së Arjanit  
dhe të Sonjës. Të dy fytyrat ishin aq afër njëra-  
tjetrës, sa ajo pati frikë se do të shkriheshin  
në një. Pati dhe ajo një dëshirë të fuqishme ta  
bashkonte fytyrën e saj me to dhe ashtu bëri.  
Në mëngjes, dy mikeshat të trulloksura panë

një fytyrë cinike mashkulli që u largua plotësisht i kënaqur dhe rrezet e imta të diellit që pushtuan krevatin. Gjatë gjithë natës nuk kishin folur asnjë fjalë me njëra tjetrën. Po vështroheshin sy më sy me një vështrim të amësht, të njëtrajtshëm dhe pa asnjë domethënie. Ndërkohe të dyja ndjenin se si ai komunikim fiziologjik, ndoshta shkak i ndodhisë së pakëndshme, vazhdonte të miklonte trupat e tyre vetëm disa centimetra larg. Ky shkëmbim hormonesh femërore, tanj shumë më intensiv se kurrë më parë dhe kjo ngrohtësi trupash, i bënë mikeshat të kuptonin se ishin më tepër mike se sa armike.

## **ë ë ë**

Jemi në shtëpinë tonë. Eshtë natë. Natë dimri  
është, por në shtëpinë tonë është mjaft vapë.  
Ndjej një siklet, një siklet të madh dhe në sy  
më zbrit imazhi i mizës në gotë. Ajo, gruaja  
ime e gjorë shterpë, hap dritaren, por për çudi  
temperatura e dhomës rritet. Te hardhia që ka  
rrethuar dritaren unë shoh një gjarpër. Nuk jam  
në gjendje ta përcaktoj çfarë lloji është dhe  
çfarë ngjyre ka, por sytë dhe gjuhën që nxjerr  
herë pas here i ka të bardhë. Unë për vete nuk  
trembem. Asaj nuk ia tregoj, se nuk dua të  
frikësohet. Kjo vërteton se unë s'i kam humbur  
ndjenjat për të. Këtë po e theksoj, se në këto  
çaste ajo flet se unë s'e dashuroj, se qenkam  
i poshtër etj.etj,... Por unë s'ia tregoj gjarprin,  
se s'dua që të trembet, se ndoshta mund të

ketë ndonjë fëmijë në bark. Megjithëse jo, jo... Ah, harrova t'ju them se herë pas here dëgjohet një si qarje, një si rënkim ëëë... ëëë... dhe... heshtje ëëë... dhe heshtje. E pyes...

- Pse je veshur me rroba kaq hermetike? S'të duket as gusha, as gishti i madh i këmbës, madje as faqet nuk t'u dukérkan. Eëë dhe... heshtje. Përtej formatit të dritares së hapur duken gjarpri dhe hëna. Vapë... shumë vapë

...

- Sepse nuk dua që të më prekësh ti - përgjigjet ajo.

- Që mos të të prek unë?! Por unë do të prek përderisa ti mban akoma unazën që të kam dhuruar.

E pasi them këtë, sepse më kujtohet që në anën e majtë ajo ka një dhëmballë të prishur, në anën e djathtë të kofshës ka një shenjë djegieje, e ka dhuratë nga vëllai kur ka qenë i vogël.

- E pse të më prekësh?! Kot?! Sa për të më krijuar rrudha?

Ti je shterp. Ti kurrë s'ke për të lindur.

- Ti je shterpë e jo unë. Ti këtë e di shumë mirë. E s'mjafton kjo, por ti je dhe e çmendur.

- Unë e çmendur?! - ma kthen ajo, duke lëvizur supet në mënyrë nazike.

Vapë. Errësirë e pjesshme në dhomë. Përtej dritares... Hëna dhe gjarpri që përkëdhelen te hardhia. Eëëë... dhe ... heshtje.

- Ti je e sëmurë psiqike. Po, po, mos vështro ashtu. Ti je e sëmurë psiqike, përderisa s'ngopesh së treguari organet seksuale shoqeve të tua dhe doktorëve.
- Po ashtu vepron edhe ti.
- S'është e vërtetë ...

Eëë dhe heshtje. Hëna dhe gjarpri.

Ne kot mundohemi t'i mbushim mendjen njeritjetrit për shterpësinë tonë - ndërhyj përsëri unë. Të jap leje të bësh një fëmijë me cilindo mashkull qoftë, - shtoj në mënyrë ironike.

- Po ashtu dhe unë, - përgjigjet ajo.

Mua më vjen për të qeshur dhe dua t'i them se s'kam nevojë t'i marr leje asaj, por ... s'kam fuqi të flas.

Unë largohem me një femër dhe ajo me një mashkull. Për çudi lindim nga një fëmijë. Të dy fëmijët kanë lindur në një orë. Të dy qajnë, ëëë, ... ëëë. Valët e qarjeve përputhen njëra me tjetrën dhe qarjet duket sikur dalin nga një gojë... ë... ë... pak heshtje. Eëëë... pak heshtje. E më pas ëëëëë-ja e zgjatur, bezdisëse, çjerrëse, kristalizohet në veshin tim të majtë të rrasur në jastëkun e krevatit (pasi nga veshi i djathë nuk dëgjoj mirë këto kohë, për arsyen të përdorimit të shumtë të ilaçeve nxitëse "biologjikë"). Zgjohem i përhumbur... Ashtu i përhumbur zgjas dorën te pjesa tjetër e krevatit ku më parë flinte ajo. Ajo... pse iku ajo? Pyes veten: se mos jemi ne të parët dhe të fundit.

Sa e ndjeshme ishte ndaj çeshtjes së fëmijës.  
Por nejse..., ajo s'ka ikur akoma përgjithmonë.  
Dhe kuptohet s'ka se si të ikë, përderisa ...  
Dëgjohet ëëë-ja bezdisëse dhe çjerrëse.  
Kthehem nga ana tjetër dhe shoh se kam lë :ë  
reflektorin ndezur. Nxehtësia ka kohë siç duhet  
që ka pllakosur pas kokës sime, ka vepruar për  
bukuri në trurin tim të trazuar, duke bërë që të  
ndërtoj atë ëndërr të sikletshme.Por sidoqoftë,  
diçka është e vërtetë: ajo ka kohë që ka ikur.  
S'po marr vesh ... mos jam në ëndërr akoma.  
Përsëri ... ëëë-ja. Këtë herë më e fortë.  
Dëgjohet qartë që vjen nga dera e jashtme.  
Ngrihem. Në tokë, nga koka e krevatit ka rënë  
një libër mjekësie. Shkoj drejt derës, ashtu  
zbathur, siç jam nga shtrati, pa veshur asgjë  
me kokën e rëndë plumb, me një përzierje  
mendimesh dhe skicim skenash pa rëndësi,  
duke harruar të ndez dritën... hap derën dhe  
vërtet... një qenie po rënkon, o Zot mos jam  
në ëndërr... është apo s'është fëmijë. Fëmijë  
... po, po fëmijë qenka! Oh, po pse kaq i nxirë?!

Sa i vogël dhe sa i shëmtuar qenka, desha të  
them. Po ç'rëndësi ka. Gjithnjë më mundon  
mendimi se mos jam në ëndërr. E fus brenda.  
Eëë-ja mbush gjithë apartamentin. Tani më  
duhet të vërtetoj se s'jam në ëndërr. Filloj...  
Kur hapa derën, ndjeva ftohtësinë dhe  
lagështinë e natës apo dhe edhe të ditës që  
po gdhinte. Po, po e ndjeva në stomak. Ja...

stomaku po më dhemb. Jashtë binte shi. Po po shi... Hap me vrull dritaren dhe shikoj shiun litarë - litarë. Më duket se tabani i këmbëve më është bërë pis. Po, po, pis... Për të vërtetuar këtë, hipi si i çmendur mbi çarçafin e bardhë të krevatit, që ajo e kishte aq merak dhe kënaqem pa masë kur shoh ... formën e tabanit të vulosur nga pisllëku. Zbres. Pastaj ... shikimi, kuptohet, më ngulet te telefoni. U, harrova, po ku është kolopuç? Ai paska vajtur në kuzhinë, sa qejf... ja, paska hipur mbi tavolinë... e rrëzoi një libër, ja e theu dhe një vazo, tani më duket se do të jetë varur te perdet e dritates. Formoj shpejt numrin e shtëpisë së nënës së saj. Do t'i them se e gjeta atë, atë që dëshironte ajo "ta kthente njëherë shtëpinë mbrapsht". S'ka gjë, - thoshte dikur ajo, le të lodhem duke e rregulluar. E do t'i them se ai, hodhi një libër, theu vazon që ajo e pëlqente, rrudhi qilimin, ja tani më duket se i hodhi edhe perdet. Alo ... Alo ... heshtje. Pres. Në kuzhinë dëgjohet zhurma e rrëmujaxhiut të pritur. Alo, alo, thërras ... Heshtje. Ndërkohë lë telefonin hapur dhe shkoj t'i hedh pak ujë syve që më djegin tmerrësisht, a thua se aty kanë ndezur zjarr djajt. Pastaj shkoj në kuzhinë të shoh djalin apo vajzën tonë. Por, o Zot. Diçka po ndodh me mua sot. Mund të kem gabuar qëparë. Po, po qëparë ... pasi tani e kam shikimin të qëruar dhe trurin e kthjellët. Nuk gaboj aspak: në

kuzhinë ndodhet një mace, po, një mace, një  
maaacee... Dëshiroj të bërtas me të madhe,  
por kujtohem se nata s'ka ikur akoma plotësisht  
dhe më vjen keq t'u prish gjumin fëmijëve e  
për më tepër fëmijëve të vegjël.

Ndërkohë nga telefoni i hapur alo... alo...  
Dëgjohet alo-ja metalike e zërit të saj.

## *toilet*

Ju mund të çuditeni, por kjo që po ju them është mëse e vërtetë:BANJO-ja, në një farë mënyre ka qenë barometri i dashurisë sonë. Më kujtohet kur filluam të jetonim së bashku, sa të kujdeshëm tregoheshim për banjon. Pastronim me kujdes çdo fije floku që na binte në lavaman, çdo copë të vogël fekale që mbetej pasi kryenim nevojat personale. Ishim vërtet shumë të kujdeshëm, si e si mos të linim asnje shenjë të vogël që mund ta degustonte tjetrin. Kaluan vitet, asgjë nuk ndodhi në botë, veçse ne nganjëherë harronim pa dashje ndonjë fije floku në lavaman, ndonjë copë të vogël fekale... Derisa me kalimin e kohës banjoja u mbush me fijet e flokëve tona, me fekale...U mbush banjoja jonë, më pas gjithë apartamenti, qyteti, planeti, gjithësia...E sërish ishte po ajo kohë kur ne akoma ishim të kujdeshëm për të mos e degustuar njëri-tjetrin, por apartamenti, qyteti, planeti, gjithësia po na degustonin ne, të dy bashkë,veç e vec.

## *sytë*

Nuk e mbaj mend se në çfarë qyteti isha dhe për ku po shkoja. Di vetëm që po prisja të vinte treni me numër 23 dhe duhej të hapja sytë për të hipur vetëm në trenin me këtë numër, pasi çdo tren me numër tjetër nuk më çonte atje për ku isha nisur. Isha ulur në një nga stolat e stacionit të metrosë, duke lexuar një libër që gjithashtu nuk e mbaj mend se kush e kishte shkruar dhe për çfarë bënte fjalë. Kur dëgjova zhurmën e rrotave të trenit që po afrohej në peron, e mbylla librin, u çova në këmbë dhe u mundova të dalloj numrin. Ishte numri 37. Duhej të prisja trenin tjetër. U ula sërisht në stol dhe hapa librin. Treni ndaloi. Në një pjesë të shikimit tim filluan të hynin siluetat e njerëzve që zbrisnin dhe njerëzve që po prisnin të hipnin. Isha

gjysmë i përqendruar te libri dhe instiktivisht gjysmë i përqendruar te kjo panoramë mëse e rëndomtë e stacioneve të metrosë. Ndërkokë, pa dashje, thitha shikimet e njerëzve që ndodheshin në tren. Për pak desh e ngrita kokën për të deshifruar ftyrat që rrezonin këto shikime, por nuk e përcaktoj döt se cila shqisë e qënies time mundi të thithë dhe të veçojë një shikim të vetëm, të thellë dhe tepër kuptimplotë. Ishte një shikim i ngrontë, rrënqethës, miklues, që gati gati më frikësoi me mirësinë dhe thellësinë e tij njëkohësisht. Unë po e ndjeja të terin, në të gjithë trupin tim, qelizat e mia. E ndjeja se si po më mbështillte, duke më bërë të ndjehesha i lumtur, por edhe i pafuqishëm për ta ngritur kokën nga libri. M'u krijua përshtypja se mund ta deshifroja më mirë atë shikim me kokë ulur, pa u përballur drejpërdrejt, sy më sy. E gjitha po ndodhte në pak minuta dhe unë po përpinqesha të kapja mesazhin e këtij shikimi. Kjo nuk kishte të bënte me mendjen time, por vetëm me atë shqisë të papërcaktuar që përmenda pak më sipër. Ndërkokë, diçka më sëmboi në zemër. Shikimi filloj të fliste. Ai tha: "unë të kuptoju shumë mirë ty. Kuptoju mendimet e tua, kuptoju gjithë ç'ke menduar që kur ke qenë në bark të nënës e deri më tanë. Unë, madje, kuptoju dhe ç'po mendon e ç'po ndjen ti këto momente." Arrita në konkluzionin se kisha

të bëja me shikimin e dy syve që më kuptonin dhe një të qindën e sekondës më vonë, gjithnjë pa e ngritur kokën, kuptova se ishin sy femre, sy që më kuptonin, sytë e një femre që mund të fejohesha pa u menduar fare, të martohesha, të bëja fëmijë, të jetonim të lumtur, tmerrësisht të lumtur, deri në vdekje. Pas dy të qindash të sekondës po digjesha nga dëshira për të parë fytyrën që mbante ata sy që më kuptonin, të paktën të shikoja se ç'ngjyrë kishin. E ngrita kokën, por treni kishte kohë që ishte larguar. Kishte ikur dhe treni me numër 23, kishin ikur vite, kishin vdekur njerëz, kishte vdekur ndoshta dhe njeriu me sytë që më kuptonin... Unë isha ndeshur me mijëra sy, më mijëra shikime, por kurrë nuk kisha hasur me ata sy që më kuptonin deri në fund të shpirtit tim, të qelizave të mia, të neuroneve, hormoneve... Kam një jetë të tërë që më kot kërkoj t'i gjej ata sy, aq sa shpeshherë, e sidomos kur ndodhem në stacionet e metrosë, dyshoj se ato nuk kanë ekzistuar kurrë dhe nuk ekzistojnë: ekziston vetëm ajo shqisa ime e papëcaktuar që ëndërron çdo sekondë të jetës time të gjejë dy sy që më kuptojnë.

*ajo që nuk e dimë, ajo na duhet;  
ajo që dimë, nuk na hyn në punë*

Gëte

(Fausti)

# *përbajtja*

|                                  |    |
|----------------------------------|----|
| <i>parathënie</i>                | 7  |
| <i>lindje</i>                    | 9  |
| <i>hon</i>                       | 10 |
| <i>stresnajë</i>                 | 11 |
| <i>çdo ditë...</i>               | 12 |
| <i>shtëpia jonë</i>              | 13 |
| <i>kërmill</i>                   | 14 |
| <i>shfletim</i>                  | 15 |
| <i>limonatë</i>                  | 16 |
| <i>dashuria është orë...</i>     | 17 |
| <i>me kokën në gjunjët e tu</i>  | 18 |
| <i>shtrati yt</i>                | 19 |
| <i>femër dhe diskò</i>           | 20 |
| <i>dashuri mbi dashuri</i>       | 22 |
| <i>orë stilistike</i>            | 24 |
| <i>lirikë moderne</i>            | 27 |
| <i>ndërrim stinësh</i>           | 28 |
| <i>nata gjithmonë është larg</i> | 30 |
| <i>fjalët</i>                    | 31 |
| <i>kronikë poetike</i>           | 32 |
| <br><i>Pause Cafè</i>            | 35 |
| <br><i>grafi</i>                 | 37 |
| <i>shilarësi</i>                 | 39 |
| <i>vogëlushja</i>                | 41 |
| <i>gjakësim femëror</i>          | 48 |
| <i>ë ë ë</i>                     | 56 |
| <i>toilet</i>                    | 62 |
| <i>sytë</i>                      | 63 |

*Gjithë natën  
Eci mbi ëndërra  
Në mëngjes  
S'më dhembin këmbët  
Po zemra...*